



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 316, Datë 09.12.2022

MBI

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË
LIDHJE ME LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13, pika 1 dhe 14 pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/2 prot., datë 07.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Në vijim të Relacioni nr. 2039/2 prot., datë 07.02.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, lindi nevoja për sqarime që lidhen me dokumentacionin financiar të aplikimit të shoqërisë dhe si e tillë vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 20 (njëzet) ditë pune, për t’iu drejtuar shoqërisë me shkresën respektive në lidhje me dhënien e sqarimeve për këto çështje. Brenda 10 (dhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës që vërteton mbështetjen financiare për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 20 (njëzetë) ditë pune, afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës që vërteton mbështetjen financiare për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI